Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY
Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Në bazë të nenit 79 dhe 80 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.05/2022 Për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi Për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, Organi Shqyrtues i Prokurimit shpall:

KONKURS

Titulli i Pozitës: Vozitës për Kryetarin/en e Organit Shqyrtues të Prokurimit
Paga: Klasa 1-20 Koeficienti: 3.88
Lloji i pozitës: Nëpunës administrativ dhe mbështetës
Kohëzgjatja e kontratës: Me afat të pacaktuar
I përgjigjet: Kryetarit/es të Organit Shqyrtues të Prokurimit
Vendi: Prishtinë

Detyrat Kryesore:

- Ofrimi i shërbimeve për Kryetaren e OSHP-së, transport-vozitje, konform rregullave të komunikacionit;
- Mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e përditshme të automjetit zyrtar;
- Mban evidencën e të gjitha udhëtimeve, shënon datën, relacionin, kilometrat ditore etj; Është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga pakujdesia, apo mos përshtatja e kushteve të komunikacionit;
- Siguron qe të gjitha veprimet të jenë në pajtim me rregullat dhe rregulloret në rastin e përfshirjes në aksident incident trafiku;
- Kryen dhe detyra tjera qe kërkohen nga mbikëqyrësi të lidhura me vendin e punës në kuadër të mandatit ligjor.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

Diplomë e Shkollës së Mesme;
Patentë shoferi për kategorinë "B", e obligueshme

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publik:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës se prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji;

Përveç kushteve të lartcekura, kandidatët, për t'u pranuar si nëpunës civil, nëpunës të shërbimit publik dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kërkesa: Të kenë nivel arsimi për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; Të kalojnë me sukses procedurat e pranimit.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit:

Dokumentin e identifikimit;

Kopjet e diplomave dhe kualifikimeve;

1. Dëshmi nga Qendra për punë Sociale se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar;
2. Dëshmi nga gjykata kompetente se kandidati nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; dhe
3. Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë për të kryer detyre.

Dëshmitë e lartcekura me numër 1,2,3 kërkohen vetëm për kandidatin-en që përzgjidhen në këtë pozitë.

Shënim: **Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Organi Shqyrtues i Prokurimit-Zyra e Personelit, Rruga "Migjeni" ish-Ndërtesa e Bankës se Lubjanës, Kati i-V-të-Prishtinë.**

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit në, tel: 038/212-360/ prej orës 08:00-16:00 h.

Data e publikimit (njoftimit) të konkursit në portalin shtetëror www.konkursi.rks-gov.net është prej datës: 04/10/2024 ndërsa konkursi është i hapur për aplikim tetë (8) ditë, përkatësisht nga data: **04/10/2024** deri më datën: **18/10/2024**.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrin brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara refuzohen.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të njoftohen për vendin, datën dhe kohen e mbajtjes së intervistës me gojë nga Zyra e Personelit, nëpërmjet telefonit ose me shkrim. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë, duhet të sjellin për konfirmim të gjitha dokumentet origjinale. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.